



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislacioni IV**

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 4 shtator 2012, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**P r o c e s v e r b a l**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Shaip Muja, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti.

**Mungoi:** Petar Miletqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dren Doli – GLPS; Shefki Kastrati e Besarta Zuka – NDI; Florije Mehmeti-KDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**R e n d d i t e:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11 korrik 2012;
3. Shqyrtimi i raportit për përputhshmërinë e akteve nënligjore me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
4. Njoftim me përgjigjet në letrën dërguar pesë komisioneve homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11 korrik 2012**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e datës 11 korrik 2012.*

### **3. Shqyrtimi i raportit për përputhshmërinë e akteve nënligjore me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës**

**Albin Kurti** – Theksoi se në mbledhjen e kaluar nga eksperti Dren Doli, prej institutit Grupi për Studime Juridike dhe Politike, anëtarëve të Komisionit u është shpërndarë raporti mbi ekspertizën e bërë, për përputhshmërinë e akteve nënligjore me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm. Në mbledhjen e kaluar, eksperti Dren Doli e ka prezantuar ekspertizën, e cila parashihet të miratohet nga Komisioni dhe do t'i shërbejë grupit të punës për përgatitjen e raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në fjalë.

Raporti përbëhet prej disa kapitujve dhe rekomandimeve, ku mund të konstatohen mospërputhjet e akteve nënligjore dhe të Kushtetutës me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm. Këtë ekspertizë e vlerësoi si shumë cilësore dhe më të gjerë sesa që është kërkuar nga Komisioni.

Pas diskutimeve të deputetëve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

#### *P ë r f u n d i m*

*Miratohet në parim raporti mbi ekspertizën e bërë nga instituti Grupi për Studime Juridike dhe Politike, lidhur me përputhshmërinë e akteve nënligjore me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm.*

### **4. Njoftim me përgjigjet në letrën dërguar pesë komisioneve homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës**

**Albin Kurti** – Njoftoi se në letrën të cilën Komisioni ua ka dërguar pesë komisioneve homologe të shteteve anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, është marrë përgjigje nga dy prej tyre, nga komisioni homolog i Spanjës dhe ai i Sllovakisë. Përgjigjja nga komisioni homolog i Spanjës është se nuk kanë mjete buxhetore për ta vizituar Kosovën. Nga komisioni homolog i Sllovakisë përgjigjja është se janë më se të lumtur që t'i përgjigjen ftesës sonë, mirëpo nuk është shumë realiste që vizitën ta bëjnë këtë vit, ngase janë shumë të ngarkuar dhe se mendojnë që i takon sekretarisë që ta organizojë një takim në vitin e ardhshëm.

### **5. Të ndryshme**

1. Anëtarët e Komisioni diskutuan për ftesën e MPJ-së, që u është bërë diku në muajin qershor, për pjesëmarrje në konferencën “Kapitulli i mbyllur i Ballkanit”, e cila do të organizohet më 10 e 11 shtator 2012.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

#### *P ë r f u n d i m*

*Të kërkohet nga MPJ, që të përsëriten ftesat dhe të dërgohet agjenda për pjesëmarrje në konferencën “Kapitulli i mbyllur i Ballkanit”, që do të organizohet më 10 dhe 11 shtator.*

2. Mbështetur në Planin dhe programin e punës së Komisionit për muajin shtator, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

*P ë r f u n d i m*

*Të ftohet ministri i Ministrisë së Diasporës, z. Ibrahim Makolli për raportim të dytë në Komision, lidhur me aktivitetet dhe angazhimet e Ministrisë së Diasporës në muajin shtator.*

3. Kryetari i Komisionit i njoftoi anëtarët se me deputetët H. Hyseni, Donika Kadaj- Bujupi dhe përfaqësues të NDI-së, kanë pasur një takim të përbashkët dhe kanë kërkuar që Komisioni të mbështetet nga një ekspert, i cili do ta ndihmonte punën e Komisionit në aspektin profesional. Ai theksoi se janë dakorduar që eksperti Blerim Dervishi, i cili i ka të mbaruara studimet për marrëdhëniet politike dhe politikën e jashtme në Britani të Madhe, ta mbështesë punën e Komisionit deri në fund të këtij viti.

4. Kryetari i Komisionit tha se jemi të njoftuar se në procedurë të emërimit për poste të ambasadorëve janë dy kandidatë, për të cilët Komisioni duhet t'i zhvillojë seancat dëgjimore.

Anëtarët e Komisionit: Shaip Muja, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj- Bujupi e Hydajet Hyseni, duke u ndërlidhur me çështjen e emërimit të ambasadorëve, diskutuan edhe për: mangësitë në ligjin për emërimin e ambasadorëve; rolin formal të Komisionit në këtë procedurë; insistimin në emërimet politike të ambasadorëve; urgjencën e ndërrimit të ambasadorëve para përfundimit të mandatit të tyre katër vjeçar; nevojën për amendamentimin e ligjit dhe nevojën që Komisioni të mos anashkalohet për çështjet, të cilat janë në kompetencë të tij.

Pas diskutimit të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

*P ë r f u n d i m*

*1. Seancat dëgjimore për kandidatët e propozuar për emërim në poste të ambasadorëve do të mbahen të mërkurën, më 12 shtator 2012.*

*2. Të ftohet ministri i MPJ-së, z. Enver Hoxhaj, në një takim të përbashkët me Komisionin në gjysmën e parë të shtatorit, për të njoftuar lidhur me aktivitetet nga politika e jashtme.*

5. Kryetari i Komisionit njoftoi se në bazë të kërkesës të cilën ia kishte bërë MPJ-së, që Komisioni të njoftohet me kopjet e notave verbale të vendeve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ato i janë dërguar nga MPJ në besim dhe secili nga anëtarët e Komisionit mund t'i shikojë.

Takimi përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

\_\_\_\_\_  
Albin Kurti

